



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:004568

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05711492

A.nr.56/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni dhe me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Nikolla, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, A.H. me adresë në fshatin ..., Komuna ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati H.H. nga ..., kundër të paditurës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur me datë 19.04.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit A.H. nga fshati D., Komuna ..., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të anulohet vendimi me numër Reference ZSK 1030/21 me numër 779 të datës 10.11.2021 i të paditurës, ashtu që paditësit ti njihet e drejta në subvencionim të koshereve të bletëve për 96 koshere për vitin 2018 me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data 31.12.2018 e deri në ditën e realizimit, si dhe të detyrohet e paditura që në emër të shkaktimit të dëmit ti bëjë kompensimin e pagesave direkte për vitin 2018, në shumën e përgjithshme prej 5,760.00 Euro me kamatë ligjore prej 8% në vit nga fundi i secilit vit, **si e pa bazuar**.

A r s y e t i m

Me datën 19.04.2024 është mbajtur shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridiko-administrative, në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në prani të palës paditëse, respektivisht avokatit Hasan Haxhaj me autorizim dhe në mungesë të palës së paditur, e cila

mungesën e ka arsyetuar me parashtrësën e datës 02.04.2024, duke i propozuar gjykatës që të veprojë konform nenit 38 par.5 të LKA-së.

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë më datën 12.01.2022 dhe përmes deklaratave të përfaqësuesit të tij në seancën mbi shqyrtimin kryesor të datës 19.04.2024, i cili në këtë seancë edhe e ka precizuar padinë në aspektin objektiv, ku edhe parashtrësën e ka dorëzuar në seancë, ku kërkon nga gjykata që t'i aprovohet kërkesëpapia e paditësit dhe të anulohet vendimi me numër Reference ZSK 1030/21 me numër 779 të datës 10.11.2021 i të paditurës, ashtu që paditësit ti njihet e drejta në subvencionim të koshereve të bletëve për 96 koshere për vitin 2018 në shumë prej 1440.00 Euro me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data 31.12.2018 e deri në ditën e realizimit, si dhe të detyrohet e paditura që në emër të shkakimit të dëmit ti bëjë kompensimin e pagesave direkte në shumën e përgjithshme prej 4.320.00 Euro me kamatë, të detyrohet e paditura që paditësit ti bëjë kompensimin e pagesave direkte për vitin 2018 në shumë prej 1440.00 Euro, në shumën e përgjithshme prej 5,760.00 Euro me kamatë ligjore prej 8% në vit nga fundi i secilit vit. I njëjti shton se, sa i përket bazës ligjore papia është tërësisht e bazuar, pasi që paditësi si fermer ka aplikuar si person fizik dhe jo si person juridik, duke i plotësuar të gjitha kushtet, por se gabimisht në këtë rast ka pasur një vërtetim të gabuar të gjendjes faktike nga ana e zyrtarëve inspektues, me rastin e daljes në teren. Më tutje thekson se, deri në këto momente nuk ka qenë kontestues fakti se lartësia e pagesës për koshere për secilin aplikues të suksesshëm ka qenë në shumë prej 15 euro për koshere, ku për ne është e habitshme se si as pas vërejtjes së gjykatës pala e paditur nuk është deklaruar se pse numri kinse i munguar prej 41 koshereve, paraqet deklaram të pavërtetë në mbi 50 %. Ka theksuar se është jo i drejtë refuzimi i zyrtarëve inspektues, të cilët paditësi i fton që të shkojnë në fshatin Llapushnik për të kontrolluar edhe pjesën tjetër të kosheres, i cili fshat është në largësi vetëm 2km, ndërsa ata shprehin gaditshmëri që të shkojnë në fshatin ..., i cili fshat është në largësi rreth 20km. I njëjti në fjalën përfundimtare të tij e ka theksuar edhe faktin e nxerrjes së një akti administrativ në fund të muajit Mars të vitit 2018, i cili i detyronte fermerët se në rast të ndryshimit të vendeve të koshereve të bletëve ta informonin paraprakisht të paditurën, por që paditësi sikurse edhe shumë fermerë tjerë nuk kishte pasur njohuri për atë detyrim ligjor dhe me rastin e kontrollës së datës 04.06.2018 i kishte ftuar Inspektorët që të shkonin në fshatin ... ku i kishte edhe 47 koshere tjera. Shton se, gjykata në rastin e vendosjes në këtë çështje duhet ta ketë parasysh se 41 koshere paraqesin 42.7% të numrit 96 e që pa mëdyshje nuk ka mundur paditësit ti pezullohet e drejta për subvencionim në vitin përkatës dhe 3 vitet vijuese.

E Paditura, me parashtrësën – deklarinimin për seancë të datës 02.04.2024 të parashtruar në gjykatë, e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se vendimi i atakuar është nxjerrë konform dispozitave ligjore në fuqi dhe i ka të gjitha elementet e aktit administrativ të ligjshëm. Andaj, i propozon Gjykatës që të nxjerr Aktgjykim me të cilin refuzohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe mbetet në fuqi vendimi Nr.779 me numër Ref.ZSP.1030/21 i protokolluar me datën 17.11.2021 nr.4126/3 i të paditurës, si i bazuar në ligj.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 19.04.2024, ka administruar provat relevante si në vijim: Vendimi i datës 10.07.2018; i datës 10.12.2018; Aktvendimi i datës 21.12.2021; Vendimi i datës 06.08.2018; vendimi i datës 10.11.2021; përgjigja në ankese e datës 21.12.2021; procesverbali i kontrollit i datës 04.06.2018; çertifikata e fermerit e datës 30.04.2018; ankesa e datës 30.07.2018; vendimi i datës 06.08.2018; shkresa e datës 10.11.2021; vendimi i datës 17.11.2021; përgjigja e datës 24.03.2021; raporti i datës 10.07.2018 dhe i datës 10.04.2018; procesverbali i kontrollit i datës 19.09.2017; procesverbali i kontrollit i datës 29.06.2019, i datës 26.10.2015 dhe i datës 22.09.2016

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thëniet e padisë, përgjigjes-deklarimit të dhënë nga e paditura dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Me vendimin e datës 10.07.2018 të MBPZHR-AZHB paditësi është përjashtuar nga programet përkrahëse për tri (3) vite, me arsyetimin se fermeri, këtu paditësi, ka paraqitur të dhëna të rrejshme midis sasisë së deklarinimit dhe sasisë së verifikuar.

Kundër këtij vendimi paditësi ka paraqitur ankese në MBPZHR, e cila i është refuzuar si e pa bazuar me vendimin e datës 06.08.2018 me Nr.24/2018.

Kundër këtij vendimi paditësi ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila me Aktgjykimin e datës 07.09.2021 me numër A.nr.2110/2018 e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

Pas këtij Aktgjykimi e paditura nxjerr vendimin e kontestuar të datës 10.11.2021 me numër 779, me numër Ref.ZSP.1030/21, ku është refuzuar si e pa bazuar në tërësi, kundërthënëse dhe e pa argumentuar, kërkesëpadija e paditësit ..., me arsyetimin se me datën 04.06.2018, Komisioni për Kontroll/verifikim në vendin e ngjarjes i AZHB-së ka konstatuar se ka dallim ndërmjet numrit të bletëve të deklaruara në aplikacion dhe gjendjes faktike të verifikuar në terren sepse, fermeri kishte deklaruar 96 koshere bletësh, ndërsa Komisioni në terren vërteton se fermeri kishte vetëm 55 koshere me bletë në vendin e ngjarjes, pra numri në mes të aplikimit dhe verifikimit nuk përputhen, e kjo konsiderohet paraqitje e të dhënave të rrejshme.

Kundër vendimit të paditurës të datës 10.11.2021 me numër 779, me numër Ref.ZSP.1030/21 të MBPZHR, paditësi ... ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 12.01.2022, duke kontestuar ligjshmërinë e tij.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, gjykata iu referua Nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 i Udhëzimit Administrativ – (MBPZHR) – Nr.03/2018 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2018 të datës 13.02.2018 në të cilin përcaktohet se: “Me qëllim të shtimit të të ardhurave të bujqve për të siguruar një qëndrueshmëri ekonomike, pagesat direkte bëhen për: 1.6. Fermerët mbarështues të bletëve”, po ashtu nëni 10 paragrafi 1 përcakton se:” Kriteret e pranueshmërisë 1. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët mbarështues të bletëve janë: 1.1. Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës; 1.2. Të mbarështojnë së paku 30 shoqëri bletësh – koshere, me përjashtim të nukleusit; 1.3. Fermerët që kanë 30 deri në 50 shoqëri bletësh – koshere, mund t’i kenë të vendosura shoqëritë e bletëve - kosheret maksimumi në dy (2) bletishte, fermerët që kanë mbi 50 deri 200 shoqëri bletësh – koshere, mund t’i kenë të vendosura shoqëritë e bletëve - kosheret maksimumi në pesë (5) bletishte, fermerët që kanë mbi 200 shoqëri bletësh – koshere, mund ti kenë të vendosura shoqëritë e bletëve - kosheret maksimumi në shtatë (7) bletishte; 1.4. Fermerët aplikues, në bletishten bazë duhet të kenë së paku 30 shoqëri bletësh; 1.5. Kosheret duhet të jenë të shënjuara qartë me Numrin Identifikues të Fermës (NIF), me ngjyrë permanente; 1.6. Në momentin e kontrollit të fermerit/ aplikuesit, në rast se i mungon NIF në koshere ose është i pa lexueshëm, atëherë përjashtohet nga subvencionimi”. Gjithashtu në nenin 38 paragrafi 2, nënparagrafi 2.11 përcaktohet se: “Kontrollat në terren për Pagesat Direkte bëhen nga AZHB për të verifikuar përmbushjen e kushteve të pranueshmërisë si: numri i kafshëve, numri i koshereve të bletëve, numri i pulave vojse, numri i thëllëzave, sasia e litrave të qumështit të dorëzuara, numri i fidaneve të prodhuara, madhësia e sipërfaqes së deklaruar, kg i peshkut të shitur, litër vere të prodhuara dhe deklaruara zyrtarisht, dhe numri i therrjeve të raportuara të

gjedhit. 2. Kontrollat në terren zbatohen sipas përqindjes së aplikacioneve: 2.11. 80 % e aplikacioneve për pagesat direkte të bletëve”. Gjithashtu me nenin 41 paragrafi 6 dhe nënparagrafi 6.1 dhe 6.2 i këtij Udhëzimi përcakton se:” Aplikuesi përjashtohet nga programet përkrahëse për tri (3) vite (2018, 2019 dhe 2020) në bazë të vendimit të Agjencisë për shkeljet si ne vijim: 6.1. i ka paraqitur AZHB-së të dhëna të rrejshme sipas paragrafit 5 të këtij Neni dhe 6.2. ka penguar kontrollin zyrtar”.

Gjykata nga shkresat e lëndës ka konstatuar se paditësi ka aplikuar për Pagesa Direkte në AZHB në bazë të thirrjes për aplikim për vitin 2018, për 96 koshere bletë. Me datën 04.06.2018, Komisioni për Kontroll/verifikim në vendin e ngjarjes i AZHB-së ka konstatuar se ka dallim ndërmjet numrit të bletëve të deklaruar në aplikacion dhe gjendjes faktike të verifikuar në terren, sepse fermeri, këtu paditësi, kishte deklaruar 96 koshere bletësh, ndërsa Komisioni në terren vërteton se fermeri kishte vetëm 55 koshere me bletë në vendin e ngjarjes.

Gjykata konstaton se, në këtë rast kur gjatë kontrollit për verifikim në vendin e ngjarjes vërtetohet se numri i koshereve me bletë në mes aplikimit dhe verifikimit nuk përputhet, kjo konsiderohet paraqitje e të dhënave të rrejshme dhe ka penguar kontrollin zyrtar, andaj në bazë të këtij dallimi midis numrit të deklaruar dhe atij të verifikuar, paditësi është përjashtuar nga Programi i Pagesave Direkte për 3 vite sipas Udhëzimit Administrativ Nr.03/2018.

Paditësi është kundërthënës me deklarin e tij në aplikacion duke pretenduar se numrin tjetër të bletëve e ka zhvendosur nga fshati H... në fshatin Ky pretendim ngërthen në vetvete kundërthënie dhe si provë është e pa pranueshme për të verifikuar gjendjen faktike në një fshat tjetër të pa përcaktuar në aplikacion. Paditësi në këtë rast duhet ta kishte deklaruar numrin e saktë të koshereve të bletëve dhe paraprakisht ta njoftoj të paditurën për vendin ku gjenden ato, që të mund pastaj ky numër i deklaruar në aplikacion të verifikohet edhe në vendin e ngjarjes.

Pretendimet e përfaqësuesit të paditësit në seancë ku thekson se paditësit nuk ka mundur ti pezullohet e drejta për subvencionim në vitin përkatës për 3 vitet vijuese për shkak se 41 koshere të munguara paraqesin 42.7% të numrit 96 koshere bletësh sa ishin deklaruar, gjykata i mori si të pa bazuara, sepse bazuar në nenin 41 paragrafi 6 dhe nënparagrafet 6.1 dhe 6.2 të Udhëzimit Administrativ – (MBPZHR) – Nr.03/2018 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2018 të datës 13.02.2018 përcaktohet se:” Aplikuesi përjashtohet nga programet përkrahëse për tri (3) vite (2018, 2019 dhe 2020) në bazë të vendimit të Agjencisë për shkeljet si ne vijim: 6.1. i ka paraqitur

AZHB-së të dhëna të rrejshme sipas paragrafit 5 të këtij Neni; dhe 6.2. ka penguar kontrollin zyrtar”. Pra, në këtë rast paditësi ka paraqitur të dhëna të rrejshme dhe ka penguar kontrollin zyrtar, gjë që është në kundërshtim me nenet e lartcekura, e kjo është vërtetuar në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke mos e treguar saktë numrin e koshereve të bletëve që i kishte në vendin e ngjarjes dhe i njëjti me asnjë fakt dhe provë nuk ka mundur që ti dëshmojë pretendimet e veta, në mënyrë që në këtë çështje të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur nga e paditura.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit të dhëna në padi, por të njëjtat pretendime i refuzoi si të pa bazuara, nga arsyeja se paditësi të njëjtat nuk i ka provuar me fakte dhe prova të cilat kishin për të ndikuar që kjo gjykatë të mund të vërtetojë një tjetër gjendje faktike nga ajo që ka vërtetuar organi i paditur.

Prandaj, nga të lartë cekurat, gjykata në këtë çështje administrative vendimin e të paditurës e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm, nuk ka të meta për shkak të cilave mund të anulohet, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative, drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka hedhur poshtë si të pa lejuar ankesën e paditësit. Mbi këto arsye, gjykata kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse vlerësoi se nuk është zbatuar ligji në dëm të të njëjtit.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.56/2022 data: 19.04.2024

Bashkëpunëtore Profesionale

Donjeta Nikolla

G j y q t a r e

Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.